



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Lindita NIKOLLA

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS
PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar;

- Duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore dhe ato rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje;

- Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut për t’i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2021 në drejtim të:

- Angazhimit maksimal të Komisionit të Konkurrencës për zhvillimin normal të veprimtarisë së institucionit, të pasqyruar në miratimin e një numri total prej 94 vendimesh.

- Monitorimit të vazhdueshëm të tregjeve sensitive si: të telefonisë celulare, të prokurimeve publike, të sigurimeve, të produkteve para mjekësore, të grurit dhe miellit, etj.

- Vlerësimit të 42 rasteve të kontrollit të përqendrimeve nga të cilat Komisioni ka klasifikuar dhe autorizuar 31 raste dhe nuk ka klasifikuar 11 raste, ku tregjet më të prekura nga transaksionet e ndryshimet e kontrollit vazhdojnë të jenë edhe për vitin 2021 tregjet financiare dhe të sigurimeve, që ndiqen më pas nga tregu i energjisë elektrike, si dhe derdhjen në buxhetin e shtetit të vlerës prej 16,7 milionë lekësh si e ardhur nga përqendrimet.

- Miratimit të 28 vendimeve që lidhen me zbatimin e dispozitave ligjore për marrëveshjet e ndaluara, nga 7 vendime që janë miratuar në vitin 2020, duke përfunduar procedurat hetimore të nisura në tregjet e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve, importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, të alkooleve, të xheldezinfektuesve dhe të termometrave, hapjen e hetimeve të reja si në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve

bujqësore, tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, barnave dhe pajisjeve mjekësore.

- Miratimit të 16 vendimeve nga 7 vendime të miratuara në vitin 2020 për zbatimin e dispozitës ligjore të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar për abuzimin me pozitën dominuese në treg, në tregjet e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të GLN-së, në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve dhe tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport.

- Plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në fushën e konkurrencës, duke vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në këtë fushë nëpërmjet hartimit dhe miratimit gjatë vitit 2021 të dy akteve nënligjore në formën e udhëzuesit: udhëzimin “Mbi praktikatat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve”, si dhe udhëzimin “Mbi praktikatat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe në rastet e përqendrimeve”.

- Dhënies së kontributit për institucionet e tjera për sa i takon hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore, ku Autoriteti ka vlerësuar në total 36 akte dhe projektakte, nga të cilat 30 projektakte në tregun e energjisë dhe gazit, 2 projektakte në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura lidhur me ndryshimin e nivelit tarifor, si dhe dhënien e rekomandimeve për disa akte nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik, koncesioneve dhe shërbimit të auditimit ligjor.

- Trajnimit të vazhdueshëm të stafit të realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të BERZH-it dhe IPA-s, si dhe OECD-së, ICN-s, etj., duke bërë të mundur zhvillimin e 68 trajnimeve virtuale brenda dhe jashtë vendit, si dhe një vizitë studimore.

- Përmirësimit ndër vite të përpjekjeve të institucionit në drejtim të advokacisë përkundrejt shumë palëve në treg, si: konsumatorët, komuniteti i biznesit dhe institucionet shtetërore, ku konkretisht është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit me Autoritetin Grek të Konkurrencës.

- Ndjekjes së 20 proceseve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku Autoriteti rezulton të jetë i paditur nga ndërmarrjet për të cilat me vendimmarrje të Komisionit është konstatuar moszbatimi i masës së përkohshme për të cilat gjykata administrative e shkallës së parë i ka dhënë të drejtë Autoritetit në 14 raste.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2022 të angazhohet veçanërisht në këto drejtime:

Të orientohet drejt digjitalizimit të proceseve të monitorimit dhe hetimit të tregjeve, si dhe të zbatojë sa më parë projektin për digjitalizimin e arkivës dhe protokollit të Autoritetit.

Të nxisë komunikim më të mirë me publikun në tërësi nëpërmjet publikimit të Newsletter-it mujor të Autoritetit.

Të përmirësojë treguesit e transparencës për vendosjen në dispozicion të qytetarëve të një kategorie më të gjerë të informacionit.

Të angazhojë kapacitetet administrative të institucionit për intensifikimin e monitorimeve dhe përfundimin në një kohë të arsyeshme të procedurave hetimore jo vetëm në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit, por edhe në tregjet e tjera referuar rekomandimeve të BE-së dhe OECD-së, si në tregun e tregtimit të vajit vegjetal, tregun e tregtimit të karburanteve, tregun e shërbimeve të telefonisë celulare, tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore.

Të mbajë në monitorim përqendrimin e autorizuar në tregun e telefonisë celulare me qëllim vlerësimin e efekteve që do të sjellë në treg ndryshimi i kontrollit të shoqërive respektive.

Të përfshijë sa më parë ndryshimet për rishikim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, në procesin e konsultimit publik, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022.

Të angazhojë kapacitetet e tij administrative për adresimin e rekomandimeve cilësore për entet rregullatore dhe institucionet e administratës qendrore, si dhe për pasurimin e Platformës Parlamentare Online me këto rekomandime duke përditësuar statusin e tyre në vazhdimësi.

Të përfshihet më shumë në advokacinë e reformave që promovojnë konkurrencën në procedurat e prokurimit publik, si dhe të organizojë tryeza për bashkësinë e biznesit në mënyrë që të sigurohet konkurrenca në procedurat e prokurimit publik.

Të fokusohet në promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës dhe komunikimin e vazhdueshëm me biznesin, si dhe të intensifikojë marrëdhëniet me botën akademike për çështjet e rregullimit të tregut, me qëllim sigurimin e njohurive të nevojshme për shumë profesionistë në fushën e ligjit të konkurrencës.

Të bëjë vlerësimin ligjor dhe të japë asistencën e nevojshme për ndihmën shtetërore për plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, si dhe të bëjë vlerësime *ex-post* për rastet e dhënies së ndihmës shtetërore kur ka shqetësime për konkurrencën.

Të bëjë përpjekje për akomodimin e nevojave buxhetore për pajisjen me ambiente të përshtatshme të punës për stafin e Autoritetit.

Të angazhohet në organizimin e takimeve periodike me sipërmarrjen dhe botën akademike për të ndarë eksperiencat më të mira për parimet dhe kuadrin rregullator të konkurrencës.

Të bashkëpunojë me institucionet homologe të Bashkimit Europian për të huazuar praktikat më të mira në fushën e konkurrencës dhe të sigurojë asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë për çështje me rëndësi.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ, që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive, kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë, veçanërisht për kontratat koncesionare.

Përfshirjen e Autoritetit për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Miratuar në datën 12.5.2022